

QASJA LEADER

Udhëzues

EuropeDirect është një shërbim që ju vjen në ndihmë për të gjetur përgjigje për pyetjet që mund të keni mbi Bashkimin Evropian.

Linja falas (*):

00 800 6 7 8 9 10 11

(*) Disa operatorë të telefonisë celulare nuk japin akses në numrat 00 800 ose thirrjet drejt këtyre numrave mund të tarifohen.

Teksti i këtij botimi është për qëllim informimi dhe nuk përbën detyrim ligjor. Fotot janë e drejtë e autorit e Komisionit Evropian, nëse nuk shënohet ndryshe.

Në internet ka shumë informacione të tjera për Bashkimin Evropian. Ky informacion mund të aksesohet nëpërmjet serverit Evropa (<http://europa.eu>).

Të dhënat e katalogimit mund të gjenden në fund të këtij botimi.

Luksemburg: Zyra për Botimet Zyrtare të Komuniteteve Evropiane, 2006

ISBN 92-79-02044-7

© Komunitetet Evropiane, 2006

Riprodhimi autorizohet me kusht që të citohet edhe burimi.

Shtypur në Belgjikë

SHTYPUR NË LETËR TË ZBARDHUR PA KLORINË.

Udhëzues për Qasjen Leader

Qëllimi i këtij dokumenti

Në këtë dokument prezantohet Qasja Leader ku shpjegohet se si kjo qasje mund të funksionojë në dobi të zhvillimit të komuniteteve rurale. Në këtë dokument jepen edhe informacione bazë për mënyrën e zbatimit të qasjes në nivel vendor si pjesë integrale e politikave të Bashkimit Evropian për zhvillimin rural.

Ky dokument përfshin:

- Një përshkrim të konceptit Leader
- Tiparet kryesore të qasjes Leader
- Një shpjegim bazë për mënyrën se si funksionon qasja Leader në terren
- Pikat kryesore të kontaktit për më shumë informacion.

Ky udhëzues i drejtohet të gjithë aktorëve rural që kanë interes në krijimin apo pjesëmarrjen në nisma të zhvillimit lokal rural. Ndër këta aktorë mund të jenë drejtues në nivel qendror, rajonal apo vendor, fermerë apo anëtarë të tjerë aktivë të komunitetit rural. Të gjithë këta kanë një rol të konsiderueshëm për të luajtur në qasjen Leader.

Qëllimi ynë është t'u shpjegojmë vendimmarrësve dhe autoriteteve programore, veçanërisht në Shtetet më të reja dhe të mundshme anëtare, se çfarë është qasja Leader dhe si ta zbatojmë atë në praktikë. Po ashtu, synojmë t'u tregojmë komuniteteve rurale në BE se qasja Leader mund t'u ofrojë atyre një mundësi për të ndërmarrë iniciativën dhe të marrin pjesë aktivisht në programet e zhvillimit rural në komunitetet e tyre vendore (dhe të përfitojnë nga mbështetja financiare që e shoqëron atë).

Ky dokument synon të shërbejë si guidë prezantuese dhe e thjeshtë për t'u kuptuar. Ai nuk trajton çdo aspekt të historikut të nismës Leader dhe as rregulloret dhe procedurat administrative që e shoqërojnë atë. Informacione për këto aspekte mund të gjenden në botime të tjera. (Në këtë dokument jepen disa informacione kontakti.)

Përmbajtja

1. Qasja Leader për zhvillimin rural: Ç'është kjo?
2. Shtatë tiparet kryesore të qasjes Leader
3. Zbatimi i Leader në nivel vendor
4. Leader në të ardhmen: Përgjithësimi
5. Pika kontakti për më shumë informacion
6. Shembuj të Leader në praktikë

1. Qasja Leader për zhvillimin rural: Ç'do të thotë kjo?

Politika e zhvillimit rural është një komponent gjithnjë e më i rëndësishëm i politikës së përbashkët bujqësore. Ajo nxit zhvillimin e qëndrueshëm në zonat rurale të Evropës duke trajtuar problemet ekonomike, sociale dhe mjedisore. Më shumë se gjysma e popullsisë së BE-së jeton në zonat rurale, të cilat mbulojnë rreth 90% të të gjithë territorit të BE-së¹. Leader është një qasje novatore në politikën e BE-së për zhvillimin rural.

Leader do të thotë 'lidhje mes veprimeve të zhvillimit rural'². Siç shpjegohet edhe nga emri, është një metodë për nxitjen dhe sigurimin e zhvillimit rural në komunitetet vendore rurale dhe jo një grup masash për t'u zbatuar. Përvoja ka treguar se Leader mund të sjellë ndryshimin në jetën e përditshme të njerëzve në zonat rurale. Ai mund të luajë një rol të rëndësishëm duke mundësuar trajtimin novator të problemeve të vjetra dhe të reja rurale dhe duke u shndërruar në një lloj 'laboratori' për ngritjen e kapaciteteve vendore dhe për testimin e formave të reja për përmbushjen e nevojave të komuniteteve rurale. Leader ka prodhuar rezultate të vlefshme në shumë zona rurale në Shtetet Anëtare të BE-15³ (3) dhe mund të luajë një rol të rëndësishëm për të ndihmuar zonat rurale në shtetet e reja dhe të ardhshme anëtare të BE-së për t'u përshtatur me realitetet në ndryshim të ditëve të sotme.

Që me krijimin e tij në vitin 1991, Leader u ka ofruar komuniteteve rurale në BE instrumente për të mundësuar një rol aktiv në formësimin e të ardhmes së tyre. Ajo është zhvilluar edhe më shumë me kalimin e kohës, së bashku me pjesën tjetër të politikave të përbashkëta bujqësore. Të dhënat nga vlerësimet dhe aktorët ruralë tregojnë se qasja Leader është një mjet që funksionon mirë, në situata dhe fusha të ndryshme, duke përshtatur kështu politikat rurale me kompleksitetin tejet të madh të nevojave të zonave rurale. Për këto arsye, Leader është bërë tashmë pjesë integrale e politikës së zhvillimit rural. Duke nxitur pjesëmarrjen në nivel vendor në hartimin dhe zbatimin e strategjive të zhvillimit të qëndrueshëm, qasja Leader mund të jetë një burim i çmuar për politikën e ardhshme rurale.

Për periudhën e programimit 2007-2013, Leader nuk do të jetë më një program më vete, por do të integrohet ('përfshihet') në të gjitha programet kombëtare/rajonale të zhvillimit rural. Kjo hap mundësi të reja që qasja Leader të zbatohet në nivel edhe me të madh dhe në një gamë më të gjerë të veprimtarive të zhvillimit rural sesa deri më tani.

Qasja Leader i nxit zonat rurale të gjejnë forma të reja për t'u bërë apo për të mbetur konkurrese, për të përfituar sa më shumë nga pasuritë e tyre dhe për të kapërcyer sfidat me të cilat mund të përballen, si p.sh. plakja e popullsisë, mangësi në ofrimin e shërbimeve ose mungesë të mundësive për punësim. Në këtë mënyrë, Leader kontribuon në përmirësimin e cilësisë së jetës në zonat rurale si për familjet e fermerëve ashtu edhe për popullatën rurale në tërësi. Leader përdor një qasje gjithëpërfshirëse për të trajtuar problemet rurale. Për shembull, kjo qasje merr parasysh se të qënit konkures në prodhimin e ushqimit, sigurimi i një mjedisi tërheqës dhe krijimi i mundësive të punësimit për popullsinë vendase janë aspekte reciprokisht mbështetëse të jetës rurale, që kërkojnë aftësi specifike, teknologji dhe shërbime të përshtatshme që duhet të trajtohen si një paketë e plotë dhe me masa politikash të përshtatura.

¹ Në BE me 25 shtete anëtare (BE-25).

² Në frëngjisht, *Liaisonentreactions de développement rural*.

³ BE me 15 Shtete Anëtare para zgjerimit të vitit 2004 ku u anëtarësuan 10 shtete të tjera.

Që me krijimin e tij në vitin 1991, nisma Leader ka punuar për t'u ofruar komuniteteve rurale në BE një metodë për përfshirjen e partnerëve vendorë në drejtimin e zhvillimit të ardhshëm të zonës së tyre. Qasja Leader ka tërhequr një interes tepër të madh brenda BE-së dhe më gjerë. Kjo qasje është përvetësuar përtej rrethit të vet të përfituesve. Interesi që ka ngjallur Qasja Leader ka ndikuar administratat dhe politikat kombëtare, rajonale dhe vendore me kapacitetin e saj për të trajtuar problemet e zhvillimit nëpërmjet formave të reja të partneritetit dhe vendosjes së lidhjes mes aktivitetëve.

Qasja Leader plotëson programet e tjera evropiane dhe kombëtare. Për shembull, veprimet e Leader mund të aktivizojnë dhe mobilizojnë burimet vendore, duke mbështetur projekte para-zhvillimore (siç janë studimet e analizës dhe të fizibilitetit apo ngritja e kapaciteteve vendore), të cilat do të përmirësojnë aftësinë e këtyre zonave për të marrë dhe përdorur jo vetëm fondet e Leader por edhe burime të tjera për financimin e zhvillimit të tyre (për shembull, programe të tjera të BE-së dhe ato kombëtare të zhvillimit rural dhe rajonal). Po ashtu, Leader ndihmon sektorë dhe kategori të caktuar përfituesish, të cilët shpesh nuk marrin mbështetje, ose marrin mbështetje të kufizuar e të pamjaftueshme, në kuadër të programeve të tjera që veprojnë në zonat rurale, siç janë aktivitetet kulturore, përmirësimi i mjedisit natyror, rehabilitimi i ndërtesave të arkitekturës dhe trashëgimisë kulturore, turizmi rural, përmirësimi i lidhjeve mes prodhuesve dhe konsumatorëve, etj.

Leader nxit aktorët socio-ekonomikë të punojnë së bashku, të prodhojnë të mira dhe shërbime që mundësojnë sa më shumë vlerë të shtuar në zonat e tyre.

Historik i shkurtër i Leader

Leader u krijua në vitin 1991 me qëllim përmirësimin e potencialit zhvillimor të zonave rurale duke u mbështetur në nismat dhe aftësitë vendore, duke promovuar përvetësimin e njohurive për zhvillimin e integruar vendor dhe duke i përhapur këto njohuri në zona të tjera rurale.

(a) Leader është pjesë e një politike më të gjerë të BE-së për zhvillimin rural

Qëllimet e Leader janë në përputhje me ato të politikës së përgjithshme të BE-së për zhvillimin rural. Zhvillimi i Politikës së Përbashkët Bujqësore merr në konsideratë diversitetin e zonave dhe peizazheve rurale, identitetet e pasura vendore dhe vlerën në rritje që shoqëria i cakton mjedisit natyror të cilësisë së lartë. Këto pranohet se janë asetet kryesore të fushave rurale të BE-së.

(b) Historia e Leader

Qasje të ndryshme të zhvillimit rural që u provuan para viteve 1990 ishin përgjithësisht sektoriale, duke u fokusuar kryesisht tek fermerët dhe synonin të nxisnin ndryshime strukturore brenda bujqësisë. Ato përdornin qasjet me orientim "nga lart-poshtë", me skema të mbështetjes që përcaktoheshin nga niveli qendror apo rajonal. Aktorët vendorë nuk inkurajoheshin gjithmonë për të përvetësuar aftësi për t'u bërë arkitektë të së ardhmes të zonave të tyre.

Qasja me bazë territorin dhe ajo nga 'poshtë-lart', ku përfshiheshin komunitetet vendore dhe ku u jepej vlerë të shtuar burimeve të tyre, nisi gradualisht të shihej si një formë e re e krijimit të vendeve të reja të punës dhe hapjes së bizneseve në zonat rurale. Leader filloi në formë eksperimentale të bënte bashkë, në nivel vendor, projekte dhe ide të ndryshme, aktorë dhe burime të ndryshme. Ai u vërtetua se ishte një instrument ideal për testimin e mënyrës së rritjes së mundësive për zonat rurale.

Pjesa e territorit të BE-së ku aplikohet qasja Leader, numri i grupeve Leader dhe niveli i financimit të përcaktuar për qasjet e tipit Leader janë rritur shumë që me fillimet e Leader në vitin 1991.

(c) Konteksti i politikës: nga nisma pilot në politikë qendrore

Për sa i përket politikave, Leader u prezantua si një “nismë komunitare” e financuar nga Fondet Strukturore të BE-së. Leader ka pasur tri faza: Leader I (1991-93), Leader II (1994-99) dhe Leader+ (2000-06). Gjatë kësaj kohe, Shtetet Anëtare dhe rajonet kanë pasur programe të pavarura Leader me financime të veçanta të përcaktuara nga BE. Që nga viti 2007 e më pas, qasja e Leader do të integrohet (‘përfshihet’) brenda politikës së përgjithshme të BE-së për zhvillimin rural. Kjo do të thotë se Leader do të përfshihet në programet e përgjithshme kombëtare dhe rajonale të zhvillimit rural të mbështetur nga BE, së bashku me një sërë aksesh të tjera të zhvillimit rural. Financimi për aksin Leader nga viti 2007 do të vijë nga fondet e përgjithshme që secili shtet anëtar merr nga BE nën Fondin e ri Evropian për Zhvillim Rural (EAFRD) në mbështetje të këtij zhvillimi.

Nisma Leader	Nr. i grupeve vendor të veprimit në nivel vendor	Sipërfaqja e mbuluar	Shuma e financimit
Leader I	217	367,000 km ²	442 milionë euro
Leader II	906	1,375,144 km ²	1,755 milionë euro
Leader +	893	1,577,386 km ²	2,105.1 milionë euro

2. Shtatë veçoritë kryesore të qasjes Leader

Koncepti Leader

Koncepti kryesor që qëndron pas qasjes së Leader është se, duke pasur parasysh diversitetin e zonave rurale evropiane, strategjitë e zhvillimit janë më efektive e më efikase nëse miratohen dhe zbatohen në nivel vendor nga aktorë vendorë, të shoqëruar me procedura të qarta dhe transparente, me mbështetjen e administratave përkatëse publike dhe me ndihmën e nevojshme teknike për transferimin e praktikës së mirë.

Ndryshimi midis Leader dhe masave të tjera më tradicionale të politikave rurale është se Leader tregon se “si” të procedohet dhe jo se “çfarë” duhet bërë. Qasjen Leader e përmbledhin shtatë veçori kryesore. Këto veçori përshkruhen këtu veç e veç, por ka rëndësi që ato të konsiderohen si një instrument i tërë. Secila veçori plotëson dhe ndërvepron pozitivisht me të tjerat gjatë gjithë procesit të zbatimit, me efekte të qëndrueshme në dinamikën e zonave rurale dhe aftësinë e tyre për të zgjidhur problemet e tyre.

Shtatë veçoritë kryesore të shpjeguara




Veçoria 1: Strategji të zhvillimit vendor me bazë territorin

Qasja me bazë territorin merr një territor të vogël, homogjen dhe koheziv nga pikëpamja sociale, shpesh e karakterizuar nga tradita të përbashkëta, një identitet vendor, me ndjenjë përkatësie apo nevojash dhe pritshmëri të përbashkëta, si zonë të synuar për zbatimin e politikave. Duke pasur një zonë të tillë si referencë bën të mundur evidentimin e avantazheve dhe dobësive, rreziqeve dhe mundësive, potencialit endogjen dhe identifikimin e pengesave kryesore për zhvillimin e qëndrueshëm. Në thelb, me bazë territori do të thotë vendor.

Kjo qasje ka gjasa të funksionojë më mirë sesa qasjet e tjera, sepse bën të mundur që veprimet të përshtaten më saktë për t'iu përgjigjur nevojave reale dhe avantazhit konkurrues vendor. Zona e zgjedhur duhet të ketë koherencë të mjaftueshme dhe burime të rëndësishme në aspektin e burimeve njerëzore, financiare dhe ekonomike për të mbështetur një strategji të zbatueshme të zhvillimit vendor. Nuk është e thënë të korrespondojë me kufijtë e paracaktuar administrativë.

Qasja me bazë territorin



Përkufizimi i “zonës vendore” nuk është as universal dhe as statik. Përkundrazi, ai zhvillohet dhe ndryshon bashkë me ndryshimin social dhe ekonomik, me rolin e bujqësisë, menaxhimit të tokës dhe shqetësimet mjedisore dhe me perceptimet e përgjithshme për zonat rurale.

Veçoria 2: Qasja me orientim nga ‘poshtë-lart’

Qasja me orientim nga poshtë-lart nënkupton që aktorët vendorë marrin pjesë në vendimmarrjen në lidhje me strategjinë dhe përzgjedhjen e prioriteteve që duhet të ndiqen në zonën e tyre vendore. Përvoja ka treguar se qasja me orientim nga poshtë-lart nuk duhet të konsiderohet si alternativë ose si kundërshtim i qasjes me orientim nga lart-poshtë nga autoritetet kombëtare dhe/ose rajonale. Përkundrazi, ajo duhet të konsiderohet në kombinim dhe bashkëveprim me të me qëllim që të arrihen rezultate më të mira.

Nga shatë veçoritë e Leader më e dallueshmja është qasja nga ‘poshtë-lart’. Politikat rurale që ndjekin këtë qasje duhet të hartohen dhe zbatohen me përshtatjen më të mirë ndaj nevojave të komuniteteve të cilave këto politika u shërbejnë. Një mënyrë për të siguruar këtë është që të ftohen aktorët vendorë të marrin drejtimin dhe të bëhen pjesë. Kjo vlen edhe për BE-në me 15 dhe 25 Shtete Anëtare, por është po aq e rëndësishme në vendet që synojnë anëtarësimin në BE, ku ka probleme strukturore në bujqësi dhe shumë mundësi për të përmirësuar cilësinë e jetës rurale.

Angazhimi i aktorëve vendorë përfshin popullatën e gjerë, grupe interesi ekonomike dhe sociale dhe institucionet përfaqësuese publike dhe private. Ngritja e kapaciteteve është një komponent thelbësor i qasjes nga ‘poshtë-lart’, ku përfshihen:

- Ndërgjegjësimi, trajnimi, pjesëmarrja dhe mobilizimi i popullsisë vendase për të identifikuar avantazhet dhe dobësitë e zonës (analiza);
- Pjesëmarrja e grupeve të ndryshme të interesit në hartimin e strategjisë së zhvillimit vendor;
- Përcaktimi i kriterëve të qarta për përzgjedhjen në nivel vendor të veprimeve (projekteve) të duhura në zbatim të strategjisë.

Pjesëmarrja nuk duhet të kufizohet me fazën fillestare, por duhet të shtrihet përgjatë gjithë procesit të zbatimit, duke kontribuar në strategjinë, në realizimin e projekteve të përzgjedhura dhe në vlerësimin dhe nxjerrjen e mësimëve për të ardhmen. Ka edhe çështje të rëndësishme të transparencës të cilat duhet të trajtohen në procedurat e angazhimit dhe konsultimit me qëllim arritjen e konsensusit përmes dialogut dhe negociimit mes aktorëve pjesëmarrës.

Veçoria 3: Partneritete vendore publik-privat: grupe lokale të veprimit

Krijimi i një partneriteti vendor, i njohur si ‘grupi lokal i veprimit’ (GLV), është një veçori origjinale dhe e rëndësishme e qasjes Leader. GLV-ja ka për detyrë të identifikojë dhe zbatojë një strategji të zhvillimit vendor, të marrë vendime për ndarjen e burimeve financiare dhe menaxhimin e tyre. Grupe të tilla kanë gjasa të jenë efektive në nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm, sepse ato:

- Bashkojnë dhe kombinojnë burimet e disponueshme njerëzore dhe financiare nga sektori publik, sektori private dhe nga sektorët civilë e vullnetarë;
- Vendosin lidhjen mes aktorëve vendorë dhe projekteve të përbashkëta dhe veprimeve ndërsektoriale me qëllim arritjen e sinergjive, ndjenjën e pronësisë së përbashkët, dhe burimeve të rëndësishme për përmirësimin e konkurrueshmërisë ekonomike të zonës;
- Forcojnë dialogun dhe bashkëpunimin mes aktorëve të ndryshëm rural, të cilët shpesh kanë përvojë të pamjaftueshme në punën e përbashkët, duke zvogëluar konfliktet e mundshme dhe duke lehtësuar zgjidhjet e negociuara përmes konsultimeve dhe diskutimeve;
- Lehtësojnë, nëpërmjet ndërveprimit mes partnerëve të ndryshëm, proceset e përshtatjes dhe ndryshimit në sektorin bujqësor (për shembull, produkte cilësore, zinxhirin ushqimor), përfshirjen e shqetësimeve mjedisore, diversifikimin e ekonomisë rurale dhe cilësinë e jetës.

Grupi Lokal i Veprimit duhet të përfshijë partnerë publikë e privatë, të ketë ekuilibrat e duhur dhe të përfaqësojë grupet vendore të interesit, me pjesëmarrje nga sektorë të ndryshëm social-ekonomikë të zonës. Në nivel vendimmarrjeje, partnerët privatë dhe shoqatat duhet të përbëjnë të paktën 50% të partneritetit vendor.


Grupet lokale të veprimit mund të krijohen ad hoc marrë mbështetjen e Leader ose mund të bazohen në partneritetet që ekzistojnë më parë. I pajisur me një ekip ekspertësh dhe me kompetenca për vendim-marrje, këto grupe janë modeli i organizimit që mund të ndikojnë në zbatimin e politikave në mënyrë pozitive. Përvoja tregon se disa lloje grupesh të tilla janë zhvilluar nga këto karakteristika të përbashkëta, si rezultat i formave të ndryshme të organizimit politik dhe institucional rajonal e kombëtar si dhe me nivele të ndryshme autonomie për sa i përket miratimit të projekteve dhe menaxhimit financiar. Edhe roli dhe përgjegjësitë e grupeve lokale të veprimit kanë evoluar me kalimin e kohës në disa shtete anëtare, duke qenë se familjarizimi me qasjen Leader është bërë mjaft e njohur dhe prania e saj është rritur.

Grupet Lokale të Veprimit vendosin për drejtimin dhe përmbajtjen e strategjive të zhvillimit rural vendor si dhe marrin vendime për financimin e projekteve të ndryshme. Pagesat shpesh bëhen nga autoriteti financiar që merret me financat publike dhe jo nga grupi lokal i veprimit, në bazë të projekteve të përzgjedhura nga grupi lokal i veprimit.

Aktorët rural më aktivë në nismat vendore janë:

- Organizatat dhe bashkimet profesionale (që përfaqësojnë fermerët, profesionistët jo-bujqësorë dhe sipërmarrjet e vogla);
- Shoqatat tregtare;
- Qytetarët, banorët dhe organizatat e tyre vendore;
- Përfaqësuesit politikë në nivel vendor;
- Shoqatat mjedisore;
- Ofruesit e shërbimeve të komunitetit dhe kulturore, përfshirë këtu edhe median;
- Shoqatat e grave
- Të rinjtë

Grupi lokal i veprimit



Nga Grupi Lokal i Veprimit pritet që:

- Të bëjë bashkë grupet përkatëse të interesit të një zone në një projekt të përbashkët;
- Të ketë autonominë e vendimmarrjes dhe kapacitetin për të kuptuar qartë burimet vendore;
- Të bëjë lidhjen mes masave të ndryshme;
- Të jetë në gjendje të shfrytëzojë mundësitë që ofrohen nga bashkimi i burimeve në nivel vendor;
- Të jetë i hapur ndaj ideve novatore;
- Të jetë në gjendje të lidhë dhe integrojë qasje të ndara sektoriale.

Grupet Lokale të Veprimit delegohen për të marrë përsipër një pjesë të konsiderueshme të përgjegjësive të menaxhimit (për shembull, përzgjedhjen e projekteve, pagesat dhe detyrat për monitorimin, kontrollin dhe vlerësimin e projekteve) në lidhje me aktivitete të caktuara. Megjithatë, shkalla e autonomisë së GLV-ve mund të

ndryshojë në mënyrë të konsiderueshme në varësi të mënyrës specifike të organizimit dhe kontekstit institucional të Shteteve Anëtare. Grantet globale janë forma më e zakonshme e financimit të projekteve dhe veprimeve të Leader. Grante të tilla, të bashkëfinancuara nga BE dhe me fondet publike të shtetit anëtar, mbulojnë një pjesë të ndryshueshme të kërkesave financiare të projektit, në varësitë llojit të projektit dhe zonës.

Veçoria 4: Mundësimi i risive

Leader mund të luajë një rol mjaft të çmueshëm në nxitjen e qasjeve të reja dhe novatore për zhvillimin e zonave rurale. Risi të tilla inkurajohen duke u bërë të mundur grupeve vendore të veprimit të kenë liri të mjaftueshme dhe fleksibilitet në marrjen e vendimeve për sa i përket veprimeve që ata duan të mbështesin.

Risitë duhet të kuptohen nga shumë aspekte. Ndër to mund të jenë prezantimi i një produkti të ri, një procesi të ri, një organizate të re apo një tregu të ri. Ky përkufizim i përbashkët për risitë vlen si për zonat rurale ashtu edhe ato urbane. Megjithatë, zonat rurale, për shkak të densitetit të ulët dhe burimeve relativisht të varfra njerëzore dhe fizike, kanë lidhje më të dobëta me qendrat kërkimore dhe zhvillimore dhe mund ta kenë të vështirë të prodhojnë risi radikale, edhe pse një gjë e tillë sigurisht që është e mundur.

Inovacioni në zonat rurale mund të nënkuptojë transferimin dhe përshtatjen e risive të zhvilluara diku tjetër, modernizimin e formave tradicionale të njohurive ose gjetjen e zgjidhjeve të reja për problemet e vazhdueshme rurale, për të cilat ndërhyrjet e tjera me anë të politikave nuk kanë qenë në gjendje të japin një zgjidhje të kënaqshme dhe të qëndrueshme. Një gjë e tillë mund të japë përgjigje të reja për problemet specifike të zonave rurale.

Prezantimi i qasjes Leader, me shtatë veçoritë e saj, mund të përbëjë risi në bërjen e politikave në të drejtën e vet, gjë që mund të sjellë veprime novatore sipas metodës origjinale të miratuar për ofrimin e politikave. Për shembull, qasja me orientim nga poshtë-lart e përshkruar më sipër mund të nxisë lindjen e projekt-ideve të reja, të cilat më pas mund të mbështeten nga grupet vendore të veprimit, pasi nuk është e detyruar të përdorë një menu fikse masash. Prezantimi i teknologjive të informacionit dhe komunikimit në zonat rurale mund të bëhet një kanal i rëndësishëm për popullsinë në zonat rurale që të përdorë sa më shumë risi.

Veçoria 5: Veprime të integruara dhe shumë sektoriale

Leader nuk është program zhvillimi sektorial. Strategjia e zhvillimit vendor duhet të ketë një arsyetim shumë-sektorial, duke integruar disa sektorë aktiviteti. Veprimet dhe projektet e përfshira në strategjitë vendore duhet të lidhen dhe të bashkërendohen si një tërësi koherente. Integrimi mund të ketë të bëjë me veprime të kryera në një sektor të vetëm, me të gjitha veprimet e programit ose grupe të caktuara veprimesh ose, ajo që ka më shumë rëndësi, me lidhjet mes aktorëve të ndryshëm ekonomikë, socialë, kulturorë, mjedisorë dhe sektorë të përfshirë.

Veçoria 6: Rrjetëzimi

Rrjetëzimi ka të bëjë me shkëmbimin e arritjeve, përvojave dhe njohurive mes grupeve Leader, zonave rurale, administratave dhe organizatave të përfshira në zhvillimin rural brenda BE-së, pavarësisht nëse janë përfitues të drejtpërdrejtë të Leader. Rrjetëzimi është një mjet për transferimin e praktikave të mira, përhapjen e risive dhe përvetësimin e mësimave të nxjerra nga zhvillimi rural vendor. Rrjetëzimi forcon lidhjet mes njerëzve, projekteve dhe zonave rurale dhe në këtë mënyrë mund të ndihmojë në kapërcimin e izolimit me të cilin përballen disa rajone

rurale. Kjo në vetvete mund të ndihmojë në ndërmarrjen e projekteve të bashkëpunimit duke vënë grupet Leader në kontakt me njëri-tjetrin.

Ka disa lloje rrjetesh:

▪ **Rrjete institucionale**

Këto rrjete financohen nga Komisioni Evropian, i cili përcakton rolin e tyre. BE mbështet strukturat e rrjeteve në nivel evropian dhe kombëtar, të cilat bëjnë bashkë grupet Leader, administratat dhe të gjithë partnerët e tjerë të interesuar që janë aktivë në zhvillimin rural. Duke nisur që nga viti 2007, llojet e rrjetit institucional do të jenë:

- Një rrjet evropian për zhvillimin rural (administruar nga Komisioni)
- Një rrjet kombëtar rural, që do të krijohet në çdo Shtet Anëtar

Aktivitetet e rrjetëzimit janë përqendruar kryesisht vetëm në Leader, por që nga viti 2007 e më tej do të trajtojnë një gamë shumë më të gjerë çështjesh të zhvillimit rural. Ata do të kenë mbështetje profesionale dhe do të ndërmarrin veprimtari praktike, siç janë përgatitja e botimeve për aspekte të ndryshme të zhvillimit rural, organizimi i seminareve, analizimi i veprimeve të zhvillimit rural për identifikimin e praktikave të mira, identifikimi i tendencave zhvillimore në zonat rurale, administrimi i faqeve të internetit dhe ndihma për grupet Leader në kërkimet e tyre për partnerë të mundshëm dhe ndërmarrjen e projekteve të bashkëpunimit. Rrjeti evropian vepron edhe si pikë takimi për rrjetet dhe administratat kombëtare në çdo Shtet Anëtar me qëllim shkëmbimin e përvojës në nivel evropian. Pjesëmarrja në aktivitetet e rrjetëzimit është e detyrueshme për të gjitha grupet Leader që marrin mbështetje financiare nga BE, por janë të mirëpritur edhe grupe të tjera që mund të ofrojnë njohuritë dhe përvojën e tyre në rrjet.

▪ **Rrjetet kombëtare, rajonale dhe vendore**

Në disa shtete anëtare në nivel vendor, rajonal apo edhe kombëtar janë ngritur apo krijuar rrjete e shoqata të grupeve Leader në mënyrë më informale (për shembull, rrjeti i grupeve irlandeze dhe greke) dhe në nivel evropian (për shembull, Shoqata Evropiane Leader për Zhvillimin Rural – *European Leader Association for Rural Development* - ELARD). Shih Seksionin 5: Pikat e kontaktit.

Veçoria 7: Bashkëpunimi

Bashkëpunimi shkon përtej rrjetëzimit. Në të përfshihet grupi lokal i veprimit që ndërmerr një projekt të përbashkët me një tjetër grup Leader apo me një grup që ka qasje të ngjashme, në një tjetër rajon, shtet anëtar, apo në një shtet tjetër (jashtë BE-së).

Bashkëpunimi mund t'i ndihmojë grupet Leader për të përhapur edhe më tej aktivitetet e tyre në nivel vendor. Ai u bën të mundur atyre zgjidhjen e problemeve të caktuara ose mund t'u shtojnë vlerë burimeve vendore. Për shembull, mund të jetë një mënyrë për të siguruar sa më shumë burime të nevojshme për zbatimin e një projekti specifik, ose për të inkurajuar ndërmarrjen e veprimeve plotësuese. Disa nga shembujt e tjerë janë marketingu i përbashkët nga grupet Leader në rajone të ndryshme, zonat e të cilave kanë një specialitet të përbashkët për një produkt të caktuar (si gështenja, leshi, etj.), ose ndërmarrja e nismave të përbashkëta turistike bazuar në një trashëgimi kulturore të përbashkët (kelt, romak, etj.).

Projektet e bashkëpunimit nuk janë thjesht shkëmbime përvojash. Ato duhet të përfshijnë një projekt konkret të përbashkët, që do të ishte mjaft mirë të administrohet nga një strukturë e përbashkët. Ka dy lloje bashkëpunimi të mundshëm në Leader:

- Bashkëpunimi ndërterritorial: kjo nënkupton bashkëpunimin mes zonave të ndryshme rurale brenda një Shteti Anëtar. Ky bashkëpunim mund të realizohet mes grupe Leader, por ai është i hapur edhe për grupe të tjera vendore që përdorin të njëjtën qasje me pjesëmarrje;
- Bashkëpunimi ndërshtetëror: kjo nënkupton bashkëpunimin mes grupeve Leader nga të paktën dy Shtete Anëtare ose me grupe në vende të tjera (jashtë BE-së) që përdorin të njëjtën qasje.

3. Zbatimi i Leader në nivel vendor

Shtatë veçoritë kryesore shpjegojnë se çfarë është qasja Leader. Zbatimi i këtyre parimeve në praktikë do të thotë që vetë njerëzit të hartojnë strategjitë vendore dhe të marrin pjesë në veprimtaritë e tyre. Në këtë seksion përshkruhen disa hapa bazë në procesin e zbatimit të Leader, në ato fushat ku kjo qasje përdoret për herë të parë. Ky seksion nuk tenton të përshkruajë çdo situatë që mund të lindë - sepse veprimtaritë Leader janë tejet të larmishme për të bërë të mundur një gjë të tillë.

Përfshirja e aktorëve vendorë në ato fusha ku Leader nuk është aplikuar asnjëherë fillon kur është bërë e qartë se një shtet anëtar apo rajon në të ardhmen e afërt do të nisë zbatimin e Leader (për shembull, me pranimin si anëtar në BE) dhe në kohën e duhur do të shpallë thirrje të hapur për propozime për grupe të mundshme Leader⁴.

Në një situatë ideale, për të vënë në zbatim qasjen Leader duhet të ndërmerren hapat e mëposhtëm:

(a) Ngritje kapacitetesh

Ky është hapi i parë në zbatimin e qasjes Leader në nivel vendor. Nëse kjo qasje novatore do të funksionojë mirë, aktorët vendorë do të kenë ose do të përvetësojnë aftësitë e nevojshme për sa i përket projekt ideve dhe njohurive, burimeve njerëzore për t'u angazhuar në aktivitete të caktuara dhe sigurisht në aspektin e aftësive financiare për t'i menaxhuar këto aktivitete. Në të kaluarën ky proces shpesh ishte një ushtrim i formës "mëso duke bërë". Sot përvoja e akumuluar duhet ta bëjë më të lehtë këtë proces. Përdorimi i rrjeteve dhe mjeteve të tjera të komunikimit është një ndihmë e madhe në ngritjen e kapaciteteve të tilla, pasi jo vetëm siguron informacion për Leader-in, por shërben edhe për të rritur interesin e aktorëve vendorë në hartimin e një strategjie për zhvillimin vendor rural dhe projekteve përkatëse, duke mundësuar kështu përfshirje sa më të madhe. Ngritja e kapaciteteve nuk është një aktivitet individual por kolektiv, në të cilin aktorë të ndryshëm rural njihen me qasjen dhe mënyrën e zbatimit të saj, duke u bërë të mundur atyre ta përhapin atë, të marrin pjesë në të dhe të përfitojnë prej saj.

(b) Aktorët vendorë bëhen bashkë

Hapi i dytë shpesh është organizimi i takimeve ose seminareve në zonën vendore për të bërë bashkë aktorët kryesorë të interesuar, për të ndihmuar në prodhimin e ideve dhe për t'u bërë të mundur aktorëve të diskutojnë së bashku dhe me mirëkuptim nevojat në zonën e tyre. Ka shumë forma për të bërë bashkë aktorët vendorë: seminarët dhe grupe pune, takimet publike, media dhe telekomunikacioni, panairët dhe ekspozitat janë disa nga format më të zakonshme për të mbledhur aktorët vendorë me qëllim diskutimin e çështjeve me interes të përbashkët dhe ndërgjegjësimin e tyre për opinionet dhe projektet e ndryshme për zonën.

⁴Në rastin e Shteteve Anëtare ekzistuese, mund të lindë një proces i ngjashëm kur Shtetet Anëtare ose rajonet të organizojnë një proces të ri përzgjedhjeje për grupet Leader në fillim të një periudhe të re programimi dhe ku zonat rurale të vendit që nuk janë mbështetur më parë nga Leader mund të kenë dëshirë të aplikojnë.

(c) Analiza e territorit

Ka shumë rëndësi të madhe analiza e detajuar e zonës rurale vendore. Normalisht kjo analizë fokusohet në identifikimin e “kapitalit territorial”, pra, asetet e zonës (njerëzit, aktivitetet, peisazhet, trashëgimia, njohuritë) dhe jo në formën e një inventari, por për tiparet unike që mund të zhvillohen. Analizimi i këtyre tipareve dhe pikave kryesore të identifikuar gjatë analizës së zonës duhet të sjellë si rezultat identifikimin e strategjive të mundshme të zhvillimit vendor, që lidhen pikërisht me zonën rurale në fjalë. Hartimi i një analize me bazë territorin mundëson edhe angazhimin e të gjithë aktorëve vendorë në vizionin afatmesëm dhe afatgjatë të zonës. Edhe pse njohuritë e ekspertëve janë mjaft të vlefshme në këtë analizë, ka shumë rëndësi që “vizionet” e ndryshme për të ardhmen dhe për strategjinë më të mirë për zonën të kenë mundësinë e diskutimit në publik dhe të arrihet konsensus në masën më të madhe.

(d) Identifikimi i aktiviteteve/nismave aktuale

Një hap i rëndësishëm në procesin Leader, që lidhet me analizën e territorit, është që aktorët vendorë të bëjnë një analizë të masave aktuale për zhvillimin rural, masa që janë duke u zbatuar apo janë planifikuar në zonën e tyre. Përcaktimi i nismave që janë në proces e sipër ka shumë rëndësi për marrjen e vendimeve që lidhen me vazhdimin e këtyre nismave apo zëvendësimin e tyre. Nga ana tjetër, një gjë e tillë zvogëlon rrezikun e duplikimit të punëve.

(e) Krijimi i një partneriteti

Gjatë fazës së analizës, për qasjen me orientim nga poshtë-lart kërkohet rritje e ndërgjegjësimit (nëpërmjet informacionit) dhe angazhim për të analizuar avantazhet dhe dobësitë e zonës rurale dhe për të identifikuar nevojat dhe pritshmëritë (duke përdorur metodat e analizës me pjesëmarrje). Kjo fazë ka si synim të gjithë komunitetin si dhe grupet aktive që udhëheqin procesin. Gjatë fazës së planifikimit të zgjedhjeve strategjike për zonën vendore lokale (p.sh., identifikimi i tematikave/projekteve prioritare për të cilat kërkohet mbështetje financiare), qasja me orientim nga poshtë-lart kërkon pjesëmarrjen e grupeve të ndryshme të interesit (për shembull, duke ngritur grupe pune të përkohshme).

Duke bërë bashkë aktorët vendor dhe realizimi i analizës së territorit bëjnë të mundur identifikimin e atyre që duhet të përfshihen në partneritetin publik-privat dhe menaxhimin e zbatimit të tij. Rrjedhimisht, kjo çon në krijimin e një grupi vendor lokal veprimi. Ky grupim është partneriteti i cili zbaton me efektivitet qasjen e zhvillimit vendor të miratuar nga vetë komuniteti.

(f) Përgatitja e strategjisë së zhvillimit vendor

Qasja e zhvillimit vendor formalizohet në një dokument strategjik të zhvillimit vendor. Këtu përfshihen hartimi i objektivave, përcaktimi i prioriteteve strategjike dhe renditja e veprimeve që duhen ndërmarrë. Kjo strategji e zhvillimit vendor do të jetë baza e aplikimit nga ana e grupit lokal të veprimit për mbështetje sipas thirrjeve të hapura për propozime që bëhen nga shtetet anëtare/rajonet tek Leader. Shtetet anëtare ose rajonet zgjedhin grupet e suksesshme lokale të veprimit dhe u japin atyre buxhetin përkatës për zbatimin e strategjive të tyre vendore.

4. Leader në të ardhmen: Përgjithësimi

Nga një shqyrtim i kohëve të fundit i politikave të BE-së për zhvillimin rural u arrit në përfundimin se Leader kishte arritur një nivel pjekurie që u bënte të mundur zonave rurale të zbatonin qasjen Leader më gjerë në programet e përgjithshme të zhvillimit rural. Disa shtete anëtare, që janë anëtarësuar në BE në vitin 2004, kanë miratuar tashmë masa të gjithanshme të tipit Leader në programet e tyre 2004-2006.

(a) Periudha e ardhshme e programimit (2007-2013)

Theks i ri për Leader

Më 20 shtator 2005, Këshilli miratoi një rregullore të re për mbështetjen e zhvillimit rural për periudhën e ardhshme të programimit (2007-13)⁵. Në këtë rregullore i vihet më shumë theks qasjes së tipit Leader. Gjatë periudhës së ardhshme, çdo program i zhvillimit rural duhet të ketë një komponent Leader për zbatimin e strategjive të zhvillimit vendor me qasje nga 'poshtë-lart'. Të paktën 5% e fondeve të BE-së për secilin program duhet të rezervohen për Leader (si një zë më vete "Leader" brenda programeve). Kjo përqindje do të ndahet në disa faza për Shtetet Anëtare të BE-10⁶, të cilat do të aplikojnë mesatarisht 2.5% për Leader në periudhën 2007-2013, duke pasur parasysh edhe përvojën e tyre më të kufizuar në qasjen Leader. Shtetet Anëtare ose rajonet do të zgjedhin Grupet Lokale të Veprimit në bazë të strategjive të propozuara të zhvillimit vendor. Secili program do të ketë tagrin për të financuar ngritjen e kapaciteteve dhe inkurajimin e nevojshëm për përgatitjen e këtyre strategjive vendore, kostot operative të strukturave të grupeve vendore të veprimit, dhe zbatimin e strategjive të zhvillimit vendor dhe projektet e bashkëpunimit mes këtyre grupeve. Do të ketë edhe struktura rrjeti të përforcuara me krijimin e Rrjetit Evropian për Zhvillim Rural (shih Seksioni 2, Veçoria 6).

(b) Fokusi tek shtetet e reja anëtare dhe shtetet që synojnë anëtarësimin

Aktivitetet bujqësore luajnë një rol tejet të rëndësishëm në zhvillimin rural tek shtetet anëtare dhe tek ato që synojnë të anëtarësohen në BE. Ndryshimet institucionale dhe strukturore në sektorin e bujqësisë gjatë dhjetëvjeçarit të fundit kanë shkaktuar një nivel të lartë papunësie afatgjatë, shpopullim në disa zona dhe mangësi në ofrimin e shërbimeve dhe infrastrukturës. Qasja e fuqizuar nga 'poshtë-lart' e LEADER, qasje që u jep autoriteteve dhe komuniteteve vendore më shumë zë në hartimin dhe zbatimin e programeve për të përmbushur nevojat vendore dhe që i konsideron zonat rurale si territore dhe nuk përqendrohet vetëm në sektorin bujqësor, do të jetë me rëndësi të madhe edhe për ato vende që aspirojnë të anëtarësohen në BE. Shumë prej këtyre vendeve në vitet e fundit kanë pasur përvojë të kufizuar të qasjeve të tilla me pjesëmarrje. Që nga anëtarësimi në 1 maj 2004, Shtetet Anëtare të BE-10 kanë tashmë mundësinë të zbatojnë një masë të përgjithësuar të llojit Leader të financuar nga Seksioni i Udhëzimit EAGGF⁷. Gjashtë nga 10 shtetet e reja anëtare e kanë përfshirë masën e llojit Leader në

⁵ Rregullore e Këshillit (KE) Nr. 1698/2005 i datës 20 shtator 2005 për mbështetjen e zhvillimit rural nga Fondi Evropian i Bujqësisë për Zhvillimin Rural (EAFRD) (OJ L 277, 21.10.2005).

⁶ 10 Shtetet e reja Anëtare që iu bashkuan BE-së në maj të vitit 2004.

⁷ Fondi Evropian i Udhëzimit dhe Garancisë Bujqësore (European Agricultural Guidance and Guarantee Fund) - EAGGF

programet e tyre tek “Objektivi 1”⁸. Më shumë theks do t’i vihet ngritjes së kapaciteteve administrative për të nxitur dhe mbështetur, për shembull, krijimin e grupeve vendore të veprimit.

⁸ Objektivi 1 i Fondeve Strukturore nxit zhvillimin dhe përshtatjen strukturore të rajoneve zhvillimi i të cilave ka mbetur prapa (periudha 2000-2006).

5. Pika kontakti për më shumë informacion

(a) Observatori Evropian Leader krijuar nga Komisioni Evropian

Adresa në internet e Observatorit Leader ofron informacione të dobishme për të gjitha aspektet e Leader. Menuja e faqes kryesore së Observatorit dhe informacioni i përgjithshëm i tij janë në të gjitha gjuhët e vendeve anëtare të Be-së së zgjeruar. Për më shumë informacion, vizitoni:

<http://ec.europa.eu/leaderplus>

Në këtë adresë jepet një lidhje (adresë) edhe për njësitë kombëtare të rrjeteve. Pika e kontaktit e Observatorit Leader+

contact.point@leaderplus.org

Tel. (32-2) 235 20 20

Faks (32-2) 280 04 38

Për më shumë informacione për masat e BE-së për zhvillimin rural vizitoni:

http://ec.europa.eu/agriculture/rur/index_en.htm

(b) Niveli kombëtar/rajonar

Burimet më të afërta të informacionit për të interesuarit ka të ngjarë të jenë në nivel kombëtar/rajonar, në varësi të strukturave të programimit të vendit në fjalë. Këto burime janë të shumta në numër për t'u përmendur këtu, por mund të gjenden ose duke përdorur burimet e njohura kombëtare ose duke ndjekur adresën si më poshtë:

Për Shtetet ekzistuese Anëtare të BE-së:

http://ec.europa.eu/agriculture/rur/leaderplus/memberstates/index_en.htm

Për shtetet në prag anëtarësimi dhe vendet kandidatë:

http://ec.europa.eu/agriculture/use/index_en.htm

(c) Rrjete të tjera të dobishme

ELARD (European Leader Association for Rural Development – Shoqata Evropiane Leader për Zhvillimin Rural)

ELARD është një shoqatë jofitimprurëse e krijuar në vitin 1999, që përfaqëson mbi 600 grupe vendore veprimi nga nëntë shtetet anëtare të BE-së, nëpërmjet rrjeteve të tyre kombëtare ose edhe si anëtarëve të veçantë.

<http://personal.telefonica.terra.es/web/elard/>

Prepare (Partnership for Rural Europe - Partneriteti për Evropën Rurale)

Programi Prepare synon të forcojë shoqërinë civile në zonat rurale, veçanërisht në 10 shtetet e reja anëtare dhe në vendet që synojnë të anëtarësohen si dhe të nxisë shkëmbimin e përvojës mes shteteve në zhvillimin rural. Ky program i vë theks të veçantë nxitjes së partneritetit mes organizatave joqeveritare (OJQ) dhe qeverisë për zhvillimin rural, rrjedhimisht, edhe për Qasjen Leader.

<http://www.preparenetwork.org/index.php>

(d) Botimet nga Leader

Botimet më të fundit të Leader+ të Observatorit Evropian (Lajmet Flash të Leader+ [*Leader+ FlashNews*] dhe Revista Leader+ [*Leader+ Magazine*]) mund të gjenden në adresën në internet të Leader+ (shih 5(a) më sipër).

Revista Leader+ [*Leader+ Magazine*] publikohet tre herë në vit dhe shërben si referencë me informacione për projektet që janë zbatuar apo po zbatohen nën Leader+. Këtu jepen edhe raste studimore.

Lajmet Flash [*Leader+ FlashNews*] ofron rregullisht të reja për atë që ndodh në zhvillimin rural, si nga aktivitetet e Leader ashtu edhe për botime me interes, në nivel BE-je. Është mirë ta filloni nga kjo adresë për t'u informuar për Leader. Në këtë adresë ka edhe një seksion ndërveprimi ku mund të jepni kontributin tuaj dhe të abonoheni.

Një formë online regjistrimi mund të përdoret për t'u abonuar direkt në Revistën Leader+ dhe Lajmet Flash të Leader+.

Rrjetet Kombëtare Leader të shteteve anëtare botojnë rregullisht materiale, të cilat mund të gjenden në adresën:

http://ec.europa.eu/agriculture/rur/leaderplus/publications/nnu_en.htm

6. Shembuj të Leader në praktikë

Vlera e Leader demonstrohet nga projektet shumë të vlefshme të mbështetura në vitet e fundit, që kanë pasur ndikim të vërtetë në jetën e përditshme të njerëzve që jetojnë në zonat rurale. Shembujt e dhënë këtu japin një pamje të shumëllojshmërisë dhe origjinalitetit të strategjive të zhvillimit rural që po zbatohen nga grupet lokale të veprimit në rajone të ndryshme të Evropës. Këta shembuj tregojnë edhe mënyrën se si grupet lokale të veprimit kanë shfrytëzuar mjaft mirë mundësitë që ofrohen nga Leader për të bashkëpunuar në nivel rajonal, kombëtar dhe Evropian dhe për të krijuar rrjete bashkëpunimi me qëllim ndarjen e përvojave dhe praktikave të mira.

Shembujt (a), (b) dhe (c) janë ndër projektet e ndërmarra në nivel vendor nga grupet lokale të veprimit (GLV), ndërsa shembulli (d) është rasti i një projekti me bashkëpunim ndërshtetëror mes tre grupeve lokale të veprimit në dy Shtete Anëtare.

(a) Strategji për produkte cilësore nga rajoni Montiferru, Sardenjë, Itali

Rajoni, rrethi:	Sardenjë
Emri i GLV:	Grupi Lokal i Veprimit Montiferru, Barigadu, Sinis
Kosto totale e projektit:	8,080 Euro ⁹
Elementi i financuar nga BE:	4,096 Euro
Fonde të tjera publike:	2,619 Euro
Fonde private:	1,365 Euro

Që nga vitet 1950, zona e Grupit Lokal të Veprimit të Montiferru, ku përfshihen edhe Barigadu dhe Sinis, kishte përjetuar një shkallë të lartë migrimi të popullsisë së saj rurale drejt zonave urbane. Si rezultat, bujqësia dhe shumë aktivitete të tjera tradicionale humbën fuqinë punëtore si dhe njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të prodhuar produktet tradicionale të rajonit. Përkeqësimi gradual i situatës demografike ndikoi shumë në komunitetin vendor, duke krijuar ndjesinë e humbjes së identitetit të zonës për shkak të zhdukjes së zakoneve dhe riteve tradicionale. Nga ana tjetër, për shkak të humbjes së aktivitetit bujqësor këtu krijoheshin edhe probleme mjedisore, të tilla si erozioni i tokës dhe zhdukja e ekotipeve dhe specieve endemike.

Qëllimi kryesor i grupit lokal të veprimit të rajonit Montiferru ishte rigjallërimi i sistemit social-ekonomik i rajonit duke u mbështetur tek blegtoria dhe ndërmarrjet e vogla artizanale. Kjo u arrit me anë të:

- Shtimit të vlerës për produktet vendase dhe lehtësimi i aksesit për në tregjet vendore;
- Ruajtja e burimeve natyrore që janë në rrezik zhdukjeje;
- Promovimi i imazhit të rajonit Montiferru;
- Ringritja e trashëgimisë social-kulturore e komunitetit vendas (zakonet dhe traditat që karakterizonin më parë jetën rurale të zonës).

⁹ Kostoja totale e projektit i referohet kostos së projektit specifik të përshkruar këtu, jo buxhetit të përgjithshëm të angazhuar nga grupi vendor i veprimit

Grupi lokal i veprimit u angazhua seriozisht në procesin e shtimit të vlerës dhe sigurimit të tregut për produktet lokale bujqësore. Projekti u fokusua në një lloj djathi tipik të zonës, i quajtur ‘Casizolu’, djathë që bëhej me qumësht nga një racë e veçantë bagëtie, Modicano Sarda. Lopët kullojnë në kullota dhe prodhojnë qumësht me një aromë të veçantë “pylli dhe gjethesh”. Investimet në prodhimin e djathit Casizoluu përqendruan në përmirësimin e procesit të prodhimit; planifikimin e sigurisë ushqimore; kurse trajnimit; financimin e përpunimit; asistencë marketingu; rrjetëzimin me produkte të tjera cilësore lokale (mjaltë, vaj ulliri ekstra i virgjër, verë *malvasia*); rritjen e pranisë së djathit në sektorin e kateringut cilësor; dhe ndihmën për prodhuesit në mënyrë që këta të fundit të përmbushin kërkesat e tregut përmes teknikave të menaxhimit të zinxhirit të furnizimit.

Informacione kontakti

Personi: SalvatorePolo
Adresa: PiazzaMannusnc
I-09070 Seneghe
Tel: (39-078) 35 41 32
Faks: (39-078) 35 41 32
E-mail: galmbbs@tiscali.it

(b) Rigjallërimi i korrjeve të kallamit dhe shavarit

Rajoni, rrethi: Norfolk
Emri i GLV: Grupi Lokal i Veprimit Broads&Rivers
Kosto totale e projektit: 172,425 Euro
Elementi i financuar nga BE: 58,820 Euro
Fonde të tjera publike: 113,605 Euro

Një nga karakteristikat kryesore të peizazhit të NorfolkBroad janë fushat e gjera me kallam dhe shavar, fusha me të cilat kufizohen trupat e famshëm ujorë të kësaj zone. Ambientalistët i konsiderojnë ligatina të tilla si habitate me rëndësi ndërkombëtare, sepse janë vendi ku rriten e jetojnë bimë dhe kafshë të rralla. Kjo zonë është korrur tradicionalisht për materialet e saj të kallamit që përdoren në bizneset e ndërtimit të çatave me kallam, duke vendosur kështu një lidhje me trashëgimisë së ngritur tashmë të zonës dhe mjedisit të saj natyror.

Pavarësisht modernizimit, industria e kallamave dhe shavarit në Broads ka hasur në vështirësi të mëdha, të shkaktuara pjesërisht edhe nga importet dhe rënia e çmimeve për këto produkte. Korrësit aktualë të kallamit dhe shavarit nuk kanë mundur të zëvendësojnë makinat kryesore korrëse, ndërkohë që industria nuk ia ka dalë të tërheqë punëtorë të rinj për të zëvendësuar ata që dalin në pension. Nga një studim i vitit 2002 u evidentua se në treg nuk ishin më shumë se 20 korrës profesionistë, me shumë pak prej këtyre nën moshën 30 vjeç dhe shumica në moshë pensioni (apo që duhet të kishin dalë tashmë në pension). Morali kishte rënë në nivelin më të ulët, ku një pjesë e korrësve profesionistë nuk kishin besim tek organizatat ambientaliste, të cilat punonin për të favorizuar menaxhimin e kallamishteve nëpërmjet vullnetarëve.

Nëpërmjet financimit nga Fondet Leader+ u mundësuan trajnime dhe po rikthehen zona të reja për kultivimin e kallamit dhe shavarit, zona që më parë ishin lënë pas dore. Një gjë e tillë krijoi mundësi për biznese të reja duke rritur efikasitetin dhe të ardhurat që vilen nga fushat ekzistuese, për shembull duke siguruar makineri të reja korrëse, por edhe duke rritur mundësitë për më shumë përfitime gjatë periudhës jashtë sezonit të korrjes së kallamit dhe shavarit për anëtarët e grupit vendor të veprimit. Ka pasur përfitime të tjera më pak të prekshme, siç është krijimi i një shoqate të kultivuesve dhe korrësve të kallamit, gjë që e ka bërë më të lehtë për organizatat ambientaliste dhe aktorë të tjerë të kërkojnë pikëpamjet e bizneseve të korrjes së kallamit dhe shavarit si grup interesi për çështje të tilla si ruajtja dhe rikthimi i kallamishteve dhe projektimit i punëve për parandalimin e përmbytjeve.

Projekti i parë pati sukses në parandalimin e rënies së industrisë vendase të kallamit dhe shavarit dhe mundësoi një rritje të konsiderueshme të besimit dhe optimizmit për të ardhmen. Projekti i dytë adresoi nevoja në terma më afatgjatë të industrisë duke thithur dhe mbështetur të interesuar të rinj, duke rritur efikasitetin dhe të ardhurat e bizneseve ekzistuese dhe duke përmirësuar promovimin e kallamit dhe shavarit të rajonit të Norfolkut.

Informacione kontakti

Personi: Malcolm Hackett
Adresa: Njësia e Zhvillimit Ekonomik
Këshilli Bashkiak i Norfolkut
Këshilli Bashkiak, Martineau Lane
Norwich NR1 2DH
United Kingdom
Tel: (44-1603) 22 89 60
Faks: (44-1603) 22 33 45
E-mail: malcolm.hackett@norfolk.gov.uk
Internet: www.broadsanddrivers.org.uk

(c) E ardhme e sigurt duke respektuar edhe të shkuarën

Rajoni, rrethi:	Kymi jugor
Emri i GLV:	Sepra
Kosto totale e projektit:	59,436 Euro
Elementi i financuar nga BE:	22,968 Euro
Fonde të tjera publike:	22,968 Euro
Fonde private:	13,500 Euro

Sepra (që në finlandisht do të thotë 'shok/shoqe') është një shoqatë e regjistruar që vepron në zonat rurale të tetë bashkive në Kymi jugor, për të promovuar veprimtarinë e pavarur të njerëzve vendas. Ajo ka hartuar një program zhvillimi për këtë zonë, për të cilën është aplikuar Fondi për zhvillim Leader+ për

periudhën 2000-2006. Programi i zhvillimit mbështet projekte të vogla zhvillimi, të cilat bazohen tek idetë e vetë banorëve. Buxheti është afro 1.2 milionë euro në vit, 30% e të cilit vjen nga BE, 18% nga shteti finlandez, 12% nga tetë bashkitë dhe 40% nga vetë banorët e zonës.

Zona që mbulon Sepra ka rreth 57,000 banorë. Në 30 vitet e fundit numri i popullsisë ka rënë vazhdimisht. Ka pasur mbivendosje të punëve mes distrikteve rurale, programeve të strehimit dhe punës së bashkisë. Pjesa më e madhe e popullsisë varet nga industria apo shërbimet publike. Fare pak biznese të vogla janë zhvilluar në këtë zonë. Parimi kryesor i programit është të nxisë më tej zhvillimin e një mjedisi të këndshëm dhe të sigurt, që të mundësojë një jetësë të mirë e plot gjallëri për banorët vendas. Të gjitha veprimtaritë e financuara nga ky program bazohen në respektin për historinë, natyrën dhe banorët vendas të kësaj zone. Programi ka dy tema kryesore: a) përdorimi i burimeve natyrore dhe kulturore, dhe, b) rritja e bashkëpunimit mes zonave rurale dhe atyre urbane.

Programi synon të përmbushë objektivat e tij kryesorë me anë të:

- Përmirësimin të funksioneve të brendshme në fshatra dhe komunitete;
- Zhvillimit të shërbimeve turistike dhe shërbimeve të tjera;
- Promovimit, marketingut dhe zhvillimit të produkteve të reja apo ekzistuese vendase
- Mbështetjes së bizneseve të reja të vogla;
- Shfrytëzimit të afërsisë me Rusinë dhe Estoninë si dhe zhvillimit të lidhjeve të tjera ndërkombëtare; dhe,
- Organizimit të veprimtarive ku banorët vendas dhe të zgjedhurit e tyre të kenë mundësi të takohen.

Programi i zhvillimit fokusohet në teknologjinë e informacionit, mbrojtjen e mjedisit dhe, në mënyrë të veçantë, tek të rinjtë.

Informacione kontakti

Personi: Marja Sorvo
Adresa: Helsingintie 1A
FIN-49400 Hamina
Tel: (358-44) 277 45 14
Faks: (358-5) 230 45 15
E-mail: marja.sorvo@seprat.net
Internet: www.seprat.net

(d) Edukimi ndërshtetëror për guidë kulturore dhe administrim të muzeve rajonale: tre rajone alpine bashkëpunojnë për të ofruar një perspektivë të re

Shtetet Anëtare: Austria dhe Gjermania
Rajoni, rrethi: Landi Tirol (Austri), Regierungsbezirke Schwaben dhe Oberbayern (Gjermani)

Emri i GLV:	Ausserfern (Austri), Auerbergland (Gjermani), Ostallgäu (Gjermani)
Kosto totale e projektit:	30,000 Euro
Elementi i financuar nga BE:	15,000 Euro
Fonde private:	15,000 Euro

Rajonet Ausserfern (Austri), Auerbergland (Gjermani) dhe Ostallgäu (Gjermani) kanë hartuar projektin ndërshtetëror të trajnimit, ku përfshihen 104 pjesëmarrës, 25 lektorë dhe 47 seminare në të cilat mbulohen 20 module të ndryshme. Projekti synon të shfrytëzojë kulturën dhe historinë përkatëse të këtyre tre zonave, të cilat ndodhen në rajonin alpin në kufi mes Bavarisë dhe Austrisë.

Grupet lokale të veprimit e nisën fillimisht me “takime ku shkëmbeheshin ide” mes drejtorëve administrativë të rajoneve. Drejtorët arritën në përfundimin se strategjitë e zhvillimit të tre GLV-ve fqinje kishin shumë objektiva të përbashkët dhe se këto ngjashmëri përbënin mundësi shumë të mira për bashkëpunim në të ardhmen. Duke qenë se projektet e bashkëpunimit ndërshtetëror janë më të ndërlikuara dhe kanë më shumë rreziqe se ato të bashkëpunimit vendor, tre drejtuesit e Leader+ u vunë në kërkim të një baze më të qëndrueshme bashkëpunimi. Ata e dinin se baza e suksesit të një projekti ndërshtetëror ishte krijimi i besimit se projekti do të sillte përfitime për të tre grupet lokale të veprimit. Pas realizimit të një vlerësimi të plotë dhe të gjithanshëm të projektit, ata vendosën të bazonin bashkëpunimin tek forcimi i lidhjes së historisë dhe kulturës me turizmin dhe punësimin. Projekti, duke siguruar lidhjen mes turizmit dhe kulturës, synonte të krijonte vende të reja pune, veçanërisht për gratë, me qëllim forcimin e lidhjes mes atdheut dhe historisë së tij për të rinjtë.

Për të marrë ide dhe për të mësuar nga praktikat më të mira, të tre drejtuesit e grupeve lokale të veprimit vendosën kontakte me grupin italian lokal të veprimit në Val Venostas në Tirolin Jugor, grup që kishte zbatuar me sukses një projekt të ngjashëm me financim nga Leader.

Informacione kontakti

Personi:	Günter Salchner
Adresa:	REA Außerfern Kohlplatz 7 A-6600 Pflach
Tel:	(43-5672) 62 387
Faks:	(43-5672) 62 38 71 39
E-mail:	rea@allesausserfern.at
Internet:	www.allesausserfern.at/rea

Komisioni Evropian

QASJA LEADER - Udhëzues bazë

Luksemburg: Zyra për Botimet Zyrtare të Komuniteteve Evropiane

2006 — 23 faqe — 21 x 29.7 cm

ISBN 92-79-02044-7